



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Autoriteti Kosovar i Konkurrencës
Autoritet Kosova za Konkurenciju - Kosovo Competition Authority

Ne bazë të nenit 96 të Ligjit të Procedurës Administrative, Autoriteti Kosovar i Konkurrencës pas mbajtjes së mbledhjes së Komisionit të AKK-së me dt. 27.02.2017 bjene këtë:

V E N D I M
(Përmirësues-Korigjues)

- I. Përmirësohet - Korigjohet Vendimi i AKK nr. 41/16 i datës 06.12.2016 ashtu që në pjesën që ka të bëjë me këshille juridike ku në faqen e 8 i shtohet paragrafi **Këshille juridike**: Palët e pakënaqura nuk kanë të drejtë ankese, por pala e pakënaqur mundë të inicioj konflikt administrativ në afatin prej 30 ditëve pranë Gjykatës kompetente të Kosovës. Inicimi i konfliktit administrativ e ndalon ekzekutimin e vendimit.
- II. Pjesa tjetër e Vendimit mbetet e pandryshuar.

A r s y e t i m

Me iniciativën e vetë AKK ka konstatuar që pasi palët e kanë pranuar me shkrim Vendimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës me nr. 41/16 i datës 06.12.2016 është bërë një gabim teknik sepse i mungon këshilla juridike. Prandaj në vështrim të nenit 96 të LPA, Autoritetit Kosovar i Konkurrencës përmirësoi – Korigjoi pjesën që ka të bëjë me këshillën juridike ashtu që në faqen tetë (8) të Vendimit duhet të shtohet këshilla juridike si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kunder këtij vendimi palët nuk kane të drejt ankese.

**KOMISIONI I
AUTORITETI KOSOVAR TE KONKURRENCËS**

(_____)
Valon Prestreshi
Kryetar

(_____)
Ahmet Krasniqi
Zv. Kryetar

(_____)
Fatime Haziri
Anetare

(_____)
Muhamed Krasniqi
Anëtar

(_____)
Shaqir Morina
Anëtar